



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Dep. 04
Nr. i faq. 04
Broj, stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 03-03/2100/12
Br. Prot. 11/08/2017
Prot. No. 11/08/2017

PRISHTINE

DATË/A:	11/08/2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Fadil MUZAQI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë
CC:	z. Bajram MULAKU Kryetarë në komunën e Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)"

I nderuari z. Muzaqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)" me numër prokurimi: VU644 17 2167 521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)" me numër prokurimi: VU644 17 2167 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare përmes kërkesës të datës 06/07/2017 me numër protokoli 03-03/1619/17 iu është drejtuar Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrrisë, duke kërkuar tërë dokumentacionin në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar) me numër të prokurimit: VU644 17 2167 521.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka trajtuar dhe analizuar me kujdes tërë dokumentacionin në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar faktet si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë më datë 09.06.2017 ka publikuar ne web faqen e KRPP-së njoftimin për kontratë me titull” Ndërtimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)” në procedurë të hapur, kontratë për punë me vlerë të mesme. Sipas këtij njoftimi afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë deri më datë 03.07.2017.

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderëve, dosjet e tyre i kanë dorë zuar gjithsej shtatë Operatorë Ekonomikë. Gjatë procesit të hapjes nuk është evidentuar ndonjë vërejtje nga ana e anëtarëve të komisionit për hapje të ofertave.

Sipas evidencave të procesverbalit për hapje të ofertave OE i cili ka ofertuar me çmimin më të lirë në mesin e OE konkurrues ka qenë OE Kosova Asfalt –Ash.P.K- me çmim prej 343,564.45€.

OE i cili edhe është rekomanduar për lidhje të kontratës nga ana e komisionit vlerësues.

Gjatë shfletimit të dosjes së tenderit të këtij Operatori, Agjencia ka konstatuar se listën e kontratave dhe referencave të paraqitura nga OE në fjalë, është edhe kontrata me titull : Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës në Lubishte- Viti në vlerë prej 122,527.50€ ku si investitor figuron **N.p.sh Bageri**.

Pastaj është edhe një kontratë mbi kryerjen e punimeve në mes të OE Bageri- si investitor dhe OE Kosova Asfalt si punë kryes. Kjo kontratë është lidhur me datë 08/07/2016 dhe se vlera e kësaj kontrate është 122,527.50€. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate punimet e filluara do të kryhen në afat prej 5 ditë?! Më pas NPSH Bageri e në këtë rast investitori i lëshon një referencë punë kryesit OE Kosova Asfalt për kryerje të kënaqshme të punëve për projektin në fjalë dhe se vlera e punëve të kryera është gjithsej 122,440.00€. (DATA).

Kësaj dosje iu është bashkangjitur edhe një Kontratë me po të njëjtin titull “Rivitalizimi- asfaltimi i rrugës në fshatin Lubishtë” me numër të prokurimit VI657 16 032 521 në vlerë prej 122,527.40€ ku Autoritet Kontraktues-Investitori është Komuna e Vitisë. Sipas paragrafit 2.3 të kësaj kontrate thuhet që kjo kontratë është një vjeçare dhe se pagesat do të bëhen sipas situacioneve të punëve të kryera, pasi buxheti nuk mundëson përfundimin e këtij projekti. Pala e kontraktuar në këtë kontratë është Bageri NPSH. Në këtë kontratë nuk figuron se ka ndonjë palë konzorciumi ose

nënkontraktues. Në lidhje me këtë Agjencia me datë 02.08.2017 përmes postës elektronike iu është drejtuar Autoritetit Kontraktues me Pyetjet si në vijim:

1. A ka përfunduar ekzekutimi i projektit me titull “Rivitalizimi- asfaltimi i rrugës në fshatin Lubishtë” ?
2. OE i kontraktuar NPSH Bageri, nga ju si Autoritet Kontraktues a ka qenë në ndonjë konzorcium me ndonjë OE tjetër? Nëse jo, OE fitues a ka paraqit në dosje të tenderit nëse ka pas për qëllim të nënkontraktoj pale të treta për ekzekutimin e kontratës në fjalë?

Po në të njëjtë datë Autoriteti Kontraktues Komuna e Vitisë përmes postës elektronike iu është përgjigjur pyetjes së lartë cekur me tekstin si në vijim:

3. Projekti i rrugës “Rivitalizimi- asfaltimi i rrugës në fshatin Lubishtë”, ka përfunduar dhe është bërë pranimi i përkohshëm teknik me datën 21.12.2016.
4. OE Bageri ka qenë i vetmi kontraktues, dmth nuk ka qenë në konzorcium, ndërsa në dosjen e tenderit kishte një deklaratë për furnizim me asfalt nga LIKA Trans, nr. Biznesit 70383438.

Sipas rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik AK do të deklaron gjithashtu në DT që OE-të duhet të tregojnë në tenderin e tyre çdo pjesë të kontratës që OE ka për qëllim të nënkontraktoj te palët e treta dhe secilin nënkontraktues të propozuar. Secili nën-kontraktues i propozuar duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë dhe duhet të dorëzoj dëshmitë mbi përmbushjen e kërkesave të përshtatshmërisë. **Po ashtu nën kontraktimi nuk bënë të tejkalojë 40% të vlerës totale të kontratës.**

Në rastin në fjalë sipas konstatimeve të Agjencisë i bie që OE Kosova Asfalt nuk ka pasur fare të bëjë me ekzekutimin e projektit “Rvitalizimi- asfaltimi i rrugës në fshatin Lubishtë”. Po ashtu kjo pikë nuk është trajtuar as nga ana e komisionit për vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale”, komisioni i cili edhe ka rekomanduar OE në fjalë për dhënje të kontratës në fjalë pasi që sipas raportit të vlerësimit të datës 24.07.2017 ky OE ka çmim më të lirë të ofruar për këtë tender dhe i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosje të tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Në këtë rast OE Kosova Asfalt bie në kundërshtim edhe me Deklaratën Nën Betim të cilën e ka plotësuar dhe nënshkruar, pasi që në një pjesë të kësaj deklarate thuhet që: *Unë pranoj mundësinë sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfardo dokumneti ose deklarate që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.*

Po ashtu Neni 65 të Ligjit për Prokurim Publik neni 4 thuhet që Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate

publike, nëse operatori i tillë ekonomik: paragrafi 4.1 ka dhënë deklaratë të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes.

Agjencia gjatë vlerësimit ekzaminimin dhe krahasimit të dokumentacionit për tenderin " Asfaltimi i shtatë rrugëve lokale (projekt dy vjeçar)" ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon AK që të veprojë konform LPP për situatat e tilla duke marrë parasysh që të gjeturat ua dërgojmë në shqyrtim dhe vendosje. Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Me respekt !

AUSOVO *